



VENDIM

Nr. 142, Datë 26.11.2015

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “C & S ENERGY” SH.P.K. NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “RAPUN 3 & 4” ME FUQI TË INSTALUAR 8857 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a”; 39 pika 4 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S ENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec ”Rapun 3 & 4”,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “C & S ENERGY” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), rezulton se vërtetimi nga tatim – taksat është në proces apelimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “C & S ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Rapuni 3 & 4”, me fuqi të instaluar 8857 kW, për një afat 30 – vjeçar, me kusht që të paraqesë në ERE brenda 45 ditëve vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim – taksave.
2. Me plotësimin e afatit 45 ditor të sipërcituar, ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI